



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 18, paragrafi 3 dhe 6 , dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 04/-L-013 Për Kadastër, nenit 38, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i Statutit të Komunës së Gjilanit, me qëllim të ri-rregullimit të kufijve të ngastrave kadastrale, pas Rekomandimit të Komitetit për Pronë dhe Komitetit për Politikë dhe Financa, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me date 24.09.2013, miraton këtë :

V E N D I M

Për lejimin e ri-rregullimit të kufijve të ngastrave kadastrale komunale me ato private për nevoja të rrugës publike

I.

Me këtë Vendim, Kuvendi i Komunës së Gjilanit **Aprovon propozimin e Kryetarit të Komunës për ri-rregullimin e kufijve të ngastrave kadastrale pronë komunale me pronën private për nevoja të rrugës publike në rr. “Isa Boletini “ në Gjilan (prapa stacionit të autobusëve)-, Zona Kadastrale Gjilan.**

II.

Lejohet regjistrimi i sipërfaqes tokësore prej 12 m² nga parcela private P-70403013-4657-0 , pronarë Ismajl Hoxha, në dobi të ngastrës kadastrale P-70403013-4656-0 pronë komunale – rrugë publike. Gjithashtu lejohet regjistrimi i sipërfaqes tokësore prej 19 m² nga ngastra kadastrale 70403013-4670-0 , prone komunale – rrugë publike në dobi të ngastrës kadastrale 70403013-4672-0, prone e Ismajl Hoxha. Me këtë ri-rregullim të kufijve harmonizohet gjendja faktike në teren me gjendjen juridike në librat kadastral dhe banorëve të kësaj lagje ju sigurohet një shfrytëzim i papenguar i kësaj rruge.

III.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bënë ri-rregullimin e ngastrave dhe regjistrimin e të njejtave në regjistrat kadastral me qëllim të harmonizimit të gjendjes faktike në teren me gjendjen juridike.

VI.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizem dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadaster dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VII.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

01.Nr. 16-100735

Gjilan, më 24.09.2013

Kuvendi i Komunës

Izmi ZEKA, Kryesues